

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR PUNËSIM**  
**NË S.U.O.GJ. "KOÇO GLIOZHENI" NË POZICIONIN E PUNËS**  
**Përgjegjës i Sektorit të Hotelerisë**

Bazuar në kreun III, pika 4 të Statutit "Për procedurat e marrjes në punë në S.U.O.GJ. "Koço Gliozheni" dhe në Vendimin e Bordit të spitalit Nr. 4 dt. 16.12.2022 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Strukturën Organizative të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", shpallet thirrja për aplikim për pozicionin e lirë të punës: *Përgjegjës i Sektorit të Hotelerisë, në S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni".*

**Dorëzimi i dokumentave bëhet nga data 14 Shkurt 2024**

**pranë zyrës së arkivë-protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni",**  
**në adresën Blv. "Bajram Curri" 9 (sipër Brrylit), Tiranë (ora 9.00-16.00)**

**Pozicioni:** Përgjegjës i Sektorit të Hotelerisë në S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" Tiranë - 1 (një) punonjës

**Përshkrimi i detyrave dhe karakteristikave të punës:**

1. Përgjegjësi i zyrës së hotelerisë ka varësi direkte nga Zv/drejtori Ekonomik;
2. Në bashkëpunim me degët e tjera merr pjesë në hartimet e projekt buxhetit të vitit pasardhës dhe perspektiv;
3. Përgjegjësi i zyrës së hotelerisë ka nën përgjegjësinë e tij teknike: ndihmës inspektorin sanitar, mbikëqyr shpërndarjen e ushqimit, lavanderinë, sanitare zyre, sanitare holli, punonjës pastrimi territori dhe punonjës mirëmbajtje territori;
4. Në bashkëpunim me vartësit e tij dhe me sektorët e tjerë të Spitalit merr informacion për defektet e mundshme që ka në institucion dhe ja referon eprorit (Zv/drejtori Ekonomik) për zgjidhjen e tyre;
5. Ndjek kontratat e furnizimit me materiale e mallra të ndryshme;
6. Kryen analiza mbi përdorimin dhe zbatimin e normativave materiale dhe informon një herë në tre muaj Drejtuesit e Institucionit;
7. Organizon në bashkëpunim me financën kontrole të planifikuara si dhe kontrole të befasishme;
8. Ka përgjegjësi për hotelerinë në të gjitha shërbimet e Spitalit;
9. Përgatit projekte dhe preventivë për riparimet e ndryshme në bashkëpunim me sektorët e tjerë përkatës;
10. Organizon cdo ditë punën për riparimin e defekteve për mirëmbajtjen e godinave të Spitalit;
11. Ndjek detyrat e vartësve të tij në realizimin sasior dhe cilësor;
12. Është përgjegjës për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në sektorin që mbulon;
13. Kryen detyra të tjera sipas profilit të punës të ngarkuara nga Drejtoria e Spitalit.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret si vijon:**

**Kritere të përgjithshme:**

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrat;
- c) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale;
- d) Të mos ketë masa disiplinore, që nuk u janë shuar efektet;

**Kritere të posaçme:**

- a) Të ketë kryer arsimin e lartë universitar në Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike, niveli Master Shkencor ose i njëvlefishëm me të;
- b) Të ketë minimumi 5 (pesë) vjet eksperiencë pune, (pozicione pune që i përngjajnë profilit të punës përbëjnë avantazh);
- c) Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe kërkesat e titullarit të institucionit;
- d) Të ketë aftësi të mira komunikimi, menaxheriale dhe drejtuese, si dhe aftësi shumë të mira të organizimit të punës në grup dhe fleksibilitet në zgjidhjen e problematikave të krijuara në funksion të mbarëvajtjes së punës.
- e) Të ketë aftësi të mira për të planifikuar, motivuar dhe drejtuar punën e stafit në varësi.

#### **Të tjera:**

- a) Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore gjatë tre viteve të fundit.
- b) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

#### **Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së arkivë-protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", Tiranë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë me shkrim/Letër motivimi;
- b) Jetëshkrim (CV) të përditësuar, *(ku të përfshihen të dhënat e kontaktit – numër telefoni/e-mail)*;
- c) Diplomat e shkollës së lartë, listat e notave /fotokopje të njehsuara me origjinalin. *(Diplomat dhe dokumentacioni që vërteton arsimimin akademik, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi)*;
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet e saj, që vërtetojnë eksperiencën në punë)/vërtetim të periudhave të punësimit nga sigurimet shoqërore;
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID-së) ;
- f) Raport mjekësor për aftësinë në punë/vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Dëshmi penaliteti;
- h) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe të kualifikimeve, specializimeve, arsimimin shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe ato, që vërtetojnë faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim.
- i) Vërtetim banimi
- j) Vlerësimin e fundit nga eprori i drejtëpërdrejtë *(nëse ka)*
- k) Vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi *(nëse ka)*.
- l) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe të kualifikimeve, specializimeve, arsimimin shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe ato, që vërtetojnë faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim.

*Dokumentet mund të jenë origjinale apo të njehsuara me origjinalin.*

*Dokumentet e përfuturara në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të njehsuara sipas ligjit.*

Aplikimi dhe dokumentacioni përkatës dorëzohen/dërgohen në Zyrën e Arkivë-Protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", në adresën Blv. "Bajram Curri" *(sipër Brrylit)*, Tiranë deri në datën 14.2.2024 (brenda orarit

zyrtar), sipas një formati i cili parashkruan të gjithë dokumentacionin në dosje të aplikantit dhe firmoset nga specialisti, që merr në dorëzim kërkesën dhe aplikanti përkatës.

Aplikantët që plotësojnë kriteret, nëpërmjet aplikimit dhe dokumentacionit përkatës, njoftohen individualisht për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të intervistës me gojë nga Sektori i Burimeve Njerëzore të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" në kontaktet e përcaktuara nga aplikantët në CV-të përkatëse.

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve :**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacion e dorëzuar, lidhur me kriteret, përvojën dhe kualifikimet e lidhura me fushën e pozicionit të punës, si dhe gjatë intervistës me gojë lidhur me njohuritë mbi fushën, aftësitë, eksperiencën e mëparshme, kompetencën, motivimin dhe pritshmëritë në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.

Totali i pikëve është 40 dhe do të kryhet sipas tabelës së Shtojcës 1 të Vendimit të Bordit të spitalit Nr. 4 dt.16.12 2022 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Strukturën Organizative të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" (*bashkëlidhur njoftimit*).

#### **Dalja e rezultateve të konkurimit dhe komunikimi i tyre**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" do të shpallë fituesin në faqen e vet zyrtare. Fituesi do të njoftohet edhe nëpërmjet kontakteve të shënuara në aplikimin e paraqitur nga ana e këtij të fundit.

## SHTOJCA 1

Kriteret e vlerësimit të dosjes për kandidatët:

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1	Përvojë pune në profesion (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite experiencë pune)	0-10 pikë
2	Nota mesatare e studimeve të larta, Vleresimi bëhet sipas kësaj skeme:  Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 6.00 = 2 pikë  Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 7.00 = 4 pikë  Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 8.00 = 6 pikë  Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 9.00 = 8 pikë  Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 10.00 = 10 pikë	0 -10 pikë
3.	Dëshmi të njohjes së gjuhës/-ve të huaja, maksimumi 4 pikë:  Gjuhë e huaj e mbrojtur = 2 pikë	0-4 pikë
4.	Studime shtesë deri-4 pikë;  Master profesional 1 pikë,  Master shkencor - 2 pikë;  Diplomë shtesë- 4 pikë	0- 4 pikë
5.	Trajnime dhe dëshmi të tjera kualifiki që lidhen me fushën- maksimumi 2 pikë:  trajnime dhe kualifikime me kohëzgjatje dv javë deri në tre muaj - 1 pikë;  kualifikime nga 3 muaj e më shumë- 2 pikë;	0-2 pikë
6.	Intervista dhe referencat e punësimeve të mëparshme	0-10 pikë